

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Fikrete Destani në çështjen penale ndaj të akuzuarit nga dhe nga fshati me mbrojtësit me autorizim av dhe nga, për shkak të veprës penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 paragrafi 1 dhe nenin 31 të KPRK-s, dhe i akuzuari nga, me mbrojtësin me autorizim av nga për shkak të veprës penale Ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.999-a/2018 të datës 25.07.2018, të cilën e përfaqëson prokurori Esat Ademi, pas mbajtjes të shqyrtimit gjyqësor më datë 30.07.2018, mori dhe shpalli këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri , nga i ati , e ëma , e lindur , i lindur në , lagja rr. 19-21 me nr personal , ka të kryer shkollën fillore, pronar i biznesit “ ”, i martuar, i gjendjes ekonomike të varfër, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i gjykuar, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

E pandehura , nga i ati , e ëma e lindur , e lindur në fshatin Komuna e ku edhe jeton në me nr personal , ka të kryer shkollën e mesme, studente, e pa martuar, e gjendjes ekonomike të mesme, shqiptare, shtetase e R. Kosovës, më parë i gjykuar, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

I pandehuri , nga i ati e ëma , e lindur , i lindur në , lagja nr.185, me nr. personal , ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar - baba i 1 fëmije, i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i gjykuar, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

JANË FAJTOR

I.

Të pandehurit dhe ,

Sepse nga fillimi i vitit 2018 deri me dt.11.07.2018, rreth orës 21:35 në Gjilan, rr.” në lokalit “ ”, në bashkëkryerje të pandehurit p. si pronar i biznesit “ ” dhe e pandehura si menaxhere e biznesit dhe masazhere në “ ” në mënyrë të vazhdueshme i kanë mundësuar femrave të ndryshme që për qëllime të prostitucionit të ushtrijë përveç detyrave të tyre si masazhere edhe ushtrimin e prostitucionit. ashtu që me dt. 11.07.2017 përveç se kryen veprimtarinë e masazhës, në këmbim të parave ofron edhe shërbime seksuale dhe me aplikimin e masave të fshehta të autorizuara me urdhëresën e Gjykatës UGJK 43/2018 të dt. 26.03.2018 dhe 29.05.2018 dekorohet me klient që për çmimin 50 euro të ofrojë edhe shërbime seksuale me ç rast i

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012 (cit. sipas: n. i datë me 01.01.2013)

pranon kartëmonedhat e vërtetuara me urdhëresë në shumën 50 euro, të cilat i sekuestrohen nga policia e Kosovës ndërsa të pandehurit arrestohen.

-me çka kanë kryer veprën penale Mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 paragrafi 1, dhe neni 31 të KPRK-s.

II.

I pandehuri

Sepse nga fillimi i vitit 2018 deri me dt. 11.07.2018 me dijani ka ofruar me qera për qëllime të prostitucionit lokalit e tij në Gjilan rr. të pandehurit i cili si pronar i lokalit " " në mënyrë të vazhdueshme përveç veprimtarisë së masazhës ka mundësuar që të ushtrohet prostitucioni ashtu që më dt. 11.07.2017 përveç se kryen veprimtarinë e masazhes në këmbim të parave ofron edhe shërbime seksuale dhe me aplikimin e masave të fshehta të autorizuara me urdhëresën të Gjykatës UKGJ 43/2018 të dt. 26.03.2018 dhe 29.05.2018 dakordohet me klient që për çmimin 50 euro të ofrojë edhe shërbime seksuale me emër në këtë lokal i pranon kartëmonedhat e vërtetuara me urdhëresë në shumën prej 50 euro të cilat i sekuestrohen nga policia e Kosovës ndërsa të pandehurit arrestohen.

-me çka ka kryer veprën penale Orfimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 par 1 i KPRK-së nga neni 185 paragrafi 2 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke ju referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarve dhe , në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 45, 47, 73, 74, 75 si dhe neneve 233 dhe 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarit:

I GJYKON

I. Ndaj të pandehurit , për veprën penale nga dispozitivi I të këtij aktgjykimi, shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro, të cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2 pika 2.6 dhe neni 69 paragrafi 1 të KPRK-së i **KONFISKOHET** telefoni mobil i markës "Nokia" ngjyrë e zezë me numër serik si dhe monedhat e sekuestruara sipas vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve si mjet i kryerjes së veprës penale.

II. Ndaj të pandehurës për veprën penale nga dispozitivi I të këtij aktgjykimi, shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2 pika 2.6 dhe neni 69 paragrafi 1 të KPRK-së i **KONFISKOHET** telefoni mobil i markës "Samsung S8 Galaxy" me numër serik e sekuestruar nga e pandehura si mjet i kryerjes së veprës penale.

III. Në bazë të nenit 47 të KP-s dhe me pëlqimin e të pandehurve dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej nga 2.500 € (dy mijë e pesqind euro) dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej nga 2.000 € (dy mijë euro). Nëse të pandehurit nuk e paguajnë dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 5 (pesë) muaj burg

IV. Në bazë të nenit 83 të KP-s. koha e kaluar në paraburgim prej datës 11.07.2018 deri më 30.07.2018, të akuzuarve dhe do ju llogaritet në dënimin e shqiptuar.

V. Ndaj të pandehurit _____, për veprën penale nga dispozitivi II të këtij aktgjykimi, shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej **1.000 (një mijë euro)**, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditë i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht do ti revokohet.

V. Në bazë të nenit 83 të KP-s, koha e kaluar në paraburgim prej datës 12.07.2018 deri më 30.07.2018, të akuzuarit _____ i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

VI. Të pandehurit obligohen veq e veq të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej nga 20.00 € (njëzet euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

VII. Të akuzuarve ju shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej nga 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

ARSYETIM

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 25.07.2018 ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të akuzuarve _____ nga Gjilani dhe _____ nga fshati _____ K. _____, për shkak të veprës penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 paragrafi 1 dhe nenin 31 të KPRK-s, dhe të akuzuarit _____ nga Gjilani, për shkak të veprës penale Ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës². Po ashtu me datën 25.07.2018, në këtë gjykatë janë dorëzuar edhe marrëveshjet për pranimin e fajësisë lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti i përgjithshëm në njërën anë dhe në anën tjetër të pandehurit _____ dhe _____ me mbrojtësit e tyre av. _____ dhe _____ nga Gjilani. Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate i është rekomanduar, që ndaj të akuzuarit _____, për shkak të veprës penale, ti shqiptohet dënim me burg në dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 euro me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë, ndaj të akuzuarës _____ për shkak të veprës penale, ti shqiptohet dënim me burg në dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 euro me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë dhe ndaj të akuzuarit _____ dënim me gjobë në shumën prej 1.000 euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e dyzet) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht do ti revokohet.

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datë 30.07.2018, gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësve, ka pranuar marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga të akuzuarit dhe pas konsultimit të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre avokatët _____ dhe _____ se të akuzuarit nuk ka qenë në asnjë mënyrë të detyruar apo të shtrënguar në asnjë mënyrë të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e

² Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr 04/1-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013

çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston as një nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-s.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se të akuzuarit dhe kanë kryer veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 paragrafi 1 dhe nenin 31 të KPRK-s dhe ka kryer veprën Ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës³, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësve lidhur me dënimin, i ka shpallur fajtor të akuzuarit dhe i kanë kryer veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 paragrafi 1 dhe nenin 31 të KPRK-s dhe ka kryer veprën penale Ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës⁴. Ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat janë dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të akuzuarve , ti shqiptohet dënim me burg në dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 euro me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë, dhe , ti shqiptohet dënim me burg në dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 euro me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë, dhe ti shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 1.000 euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 (njqind e dyzet) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimin nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në të kundërtën dënimin me kusht do të revokohet, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlikuar njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit të akuzuarve, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 73 dhe 76 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të akuzuarve ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se të akuzuarit kanë arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan / Departamenti i përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se të akuzuarit kanë bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se të akuzuarit janë penduar thellë për kryerjen e këtyre veprave penale, se të njëjtit kanë premtuar se nuk do të kryejnë vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të akuzuarit me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale. Ndërsa rrethanë rënduese është se vepra penale është kryer me dashje si dhe rrezikshmëria shoqërore nga këto vepra penale.

³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 euro për _____ me zëvendësim me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 euro, dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 euro me zëvendësim me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 euro për _____ dhe _____ dënim me gjobë në shumën prej 1.000 euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 ditësh dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë për ti paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksat për Kompensimin e Viktimave në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 616/2018-Më 30.07.2018


Sekretarja juridike,

Eikrete Destani/d.v



Gjyqtari,

Veli Kryeziu/d.v



KËSHILLA JURIDIKE : kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit – Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për Gjykatën dhe palët kundërshtare.

VËREJTJE: për shkak të heqjes dorë nga e drejta në ankesë, në kuptim të neneit 485 par 2 të KPPK, aktgjykimi lëndor është bërë i plotfuqishëm më dt. 30 Korrik 2018.